

TË RINJTË në INTEGRIME (IV)

# NATO në dimensionin e ri të sigurisë civile

## NATO në rindërtimin paskonfliktual

Banka Botërore përcakton Rindërtimin pas konfliktit (PCR, *Post-Conflict Reconstruction*) si “mbështetje për tranzicionin nga konflikti në paqe, duke rindërtuar kuadrin social ekonomik të një vendi”. Deri ku mund të shkojë NATO në këtë rol të rindërtimit paskonfliktual?

Është gjithmonë interesante të shohësh çështje të rëndësishme të sigurisë ndërkombëtare dhe të bësh pyetjen “Çfarë do të ndodhte nëse...”. Çfarë do të ndodhte nëse, për shembull, SHBA-së do t'i krijohet mundësia për të pushtuar edhe një herë Irakun? Çfarë do të ndodhte nëse NATO-s do t'i duhej të ripërcaktonte edhe një herë misionin e saj në Afganistan? Çfarë do të ndodhte nëse Evropa do të niste edhe një herë procesin e stabilizimit të Ballkanit? Çfarë do të bënin ata ndryshe? Duket shumë e mundshme që në të gjitha rastet, në një rifillim të ri do të përqendroheshin më shumë dhe më fort në *rindërtimin paskonfliktual* (PCR).

Para viteve '90, shumë pak parashikohej se *Rindërtimi paskonfliktual* mund të bëhej një nga sfidat më serioze dhe më të gjata për menaxhimet ushtarake pas Luftës së Ftohtë. Ka pasur shumë pak planifikim, trajnim apo qoftë edhe njohuri për t'u specializuar në këtë fushë.

Shpesh shtrohen shumë pyetje për mjediset paskonfliktuale, si për shembull kush do të jetë përgjegjës financiarisht, ligjërish dhe moralisht për pasojat e krijuara. Por shumë pak veta vënë në dyshim një çështje: bota duhet të jetë më mirë e përgatitur për t'u angazhuar në rindërtimin e paskonfliktit (PCR).

Konfliktet ndërkombëtare qysh nga fillimet e 1990-s kanë treguar se operacionet ushtarake janë vetëm një aspekt i stabilizimit dhe rindërtimit pas konfliktit. PCR inkorporon detyra ushtarake dhe civile në pesë fusha të ndryshme:

- Ofrimin e sigurisë (ku përfshihen funksione ushtarake dhe policore);
- Dhënie e shërbimeve bazë (dmth. ujë, energji elektrike, shërbime shëndetësore);
- Ndërtimi i strukturave politike (dmth. hartimi i kushtetutës, sistemit elektoral);
- Krijimi i një infrastrukture ekonomike;
- Lehtësimin e pajtimit midis ish-grupeve ndërluftuese.

Konfliktet në Irak dhe Afganistan jo vetëm kanë nxjerrë në pah nevojën për një qasje përfshirëse civilo-ushtarake të PCR-së, por kanë tërhequr një vëmendje të paparë politike te kjo çështje. Kjo hap dritaren e mundësisë për një ndryshim institucional rrënjësor.

NATO mund të jetë çelësi për zgjidhjen e kësaj sfide mjaft të ndërlikuar. NATO tashmë ka ekspertizën më të përsosur për çështje ushtarake. NATO duhet të bëhet ekspert në çështje të rindërtimit civil po aq sa është në ato të stabilizimit ushtarak.

Përpjekjet ndërkombëtare për të ndërtuar kapacitete të *Rindërtimit paskonfliktual*, duhet të fokusohen në shndërrimin e NATO-s në një organizatë ndërkombëtare rindërtimi: duke e bërë NATO-n aktorin qendror në një rrjet të PCR-së, të partneriteteve globale me shtetet jo-anëtare dhe organizatat tjera ndërkombëtare. Ky ndryshim institucional do të ofronte një moment të rëndësishëm për çështje të PCR - duke rigrupuar resurset e tanishme të shpërndara.

**NATO siguron anijet nga sulmet e piratëve**



## Pse nevojitet NATO?

Rindërtimi paskonfliktual kërkon një ekspertizë të kombinuar ushtarake dhe civile. Asnjë organizatë nuk i ka të dyja këto kapacitete në strukturën e vet. Krijimi i një bashkëpunimi efektiv midis personelit ushtarak dhe civil kërkon përballjen me sfida të rëndësishme. NATO është organizata më e përshtatshme për të arritur këto objektiva përdisa arsye:

Së pari, NATO është më i specializuari në komponentin ushtarak të Rindërtimit paskonfliktual, duke dhënë siguri dhe stabilitet në rajonet e krizave pas konflikteve të dhunshme.

Së dyti, NATO tashmë ka testuar një qasje civilo-ushtarake përmes Ekipeve të Rindërtimit të Provincave në Afganistan (PRT - Provincial Reconstruction Team). PRT-të dhe një NATO ushtarako-civile kanë në themel të njëjtën detyrë: një veprim domethënës për rindërtim, mbështetur në aftësitë dhe ekspertizën ushtarake dhe civile.

E treta, roli i NATO-s si një Aleancë rajonale mbrojtjeje varet nga një bashkëpunim, komunikim dhe planifikimi afatgjatë ndërmjet shumë njësive ushtarake. Kjo eksperiencë është vitale për koordinimin dhe menaxhimin e rrjeteve të PCR-së.

E katërta, NATO është duke ripërcaktuar qëllimin dhe misionin e vet. NATO duhet të demonstrojë aftësi për t'iu përshtatur në mënyrë të vazhdueshme sfidave të reja të angazhimeve ushtarake. Riformatimi i misionit, ambicieve dhe shtrirjes gjeografike në një bazë më shumë globale se sa rajonale do t'i forconte fuqitë e NATO-s.



**Edhe Ushtria e Malit të Zi jep kontributin e vet në ruajtjen e paqes dhe rindërtimin paskonfliktual**

## Koncepti i ri strategjik i NATO-s

Koncepti i ri Strategjik i NATO-s është dokumenti thelbësor strategjik mbi të cilin Aleanca do të ndërtojë dhe do të udhëhiqet politikisht në vitet në vijim në veprimtarinë e vet. Koncepti i ri Strategjik kërkon t'i japë NATO-s një dimension global. Nëpërmjet vazhdimit të Programit të Partneritetit për Paqe, Planit Aksional të Anëtarësimit, Marrëveshjes së Partneritetit me Nismën e Shangait, Marrëveshjes për bashkëpunim me Rusinë si dhe Marrëveshjes për mbrojtjen e përbashkët raketore me Rusinë, Aleanca synon ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në të gjithë hemisferën veriore. Me Konceptin e ri Strategjik NATO konfiguruar nevojën për siguri globale në krahasim me periudhën e dekadave të mëparshme ku dominonte domosdoshmëria për mbrojtje të përbashkët.



**Sekretari i përgjithshëm Anders Fogh Rasmussen prezanton «Konceptin e ri Strategjik të NATO-s»**

Për here të pare NATO merr përsipër të sigurojë rrugët detare dhe oqeanike në botë kundrejt rreziqeve kriminale që vijnë nga piratet, duke hedhur kështu vështrimin përtej Atlantikut dhe Paqësorit, edhe në Oqeanin Indian. Një përkufizim të qartë merr çështja e terrorizmit e cila mbetet një prioritet, duke u konsideruar një kërcënim real dhe serioz dhe jo me një rrezik i papërcaktuar. Në dokumentin e ri strategjik janë përfshirë gjithashtu edhe nevojat e bashkëjetesës me kultura dhe religjione të ndryshme edhe brenda Aleancës.